



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 415/2 Prot.

Tiranë, më 13.04.2021

V E N D I M
Nr.38, dt. 13.04.2021

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 183, DATË 15.12.2020, TË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, përfshirë institucionin Bashkia Tiranë.

Në kuadër të procesit të verifikimit, Komisioneri ka kërkuar informacion nga Bashkia Tiranë, e cila ka raportuar nëpërmjet shkresës nr. 16801/1 prot., datë 29.05.2020, në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Në përfundim të analizimit të informacionit të dërguar nga Bashkia Tiranë me shkresën e sipërcituar, në zbatim të dispozitës ligjore të parashikuar nga germa c), e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri ka nxjerrë Vendimin Paralajmërues nr. 183, datë 15.12.2020, duke i lënë detyra institucionit për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë në rastet e nëpunësve që kanë plotësuar moshën për të përfutuar pensionin e plotë të pleqërisë.

Në vijim, Bashkia Tiranë, përmes shkresës me nr. 44303/1 prot., datë 21.12.2020, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 416/4 prot., datë 24.12.2020, ka informuar në lidhje me masat administrative të marra në zbatim të vendimit paralajmërues të Komisionerit. Konkretisht, Bashkia Tiranë ka vendosur përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil për shkak të ligjit për nëpunësit: *****, *****, *****, ***** dhe *****.

Duke analizuar materialin shkresor të dërguar nga ana e Bashkisë Tiranë, rezulton se nuk janë zbatuar detyrat e lëna në vendim për punonjësit: *****, në pozicionin e punës “*Specialist i Përkrahjes Sociale, Zyra e Shërbimeve Sociale, Njësia Administrative Zall-Bastar*” dhe *****, në pozicionin e punës “*Kryeinspektor, Auditi i Brendshëm*”, Bashkia Tiranë.

Në kushtet kur afati ligjor për përmbushjen e detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues ka përfunduar, Komisioneri me shkresën nr. 415 prot., datë 17.03.2021, ka kërkuar nga Bashkia Tiranë që brenda 7 ditëve të dërgojnë informacion në lidhje me masat që janë marrë për zbatimin e vendimit të mësipërm në lidhje me këto dy nëpunës dhe të vërë në dispozicion të Komisionerit të gjithë praktikën shkresore që materializon këtë proces.

Me shkresën nr. 11895/1 prot., datë 01.04.2021, Bashkia Tiranë ka informuar për arsyet e mos shkëputjes së marrëdhënieve të punës për nëpunësit në fjalë, si dhe ka kërkuar shtyrjen e afatit të ndërprerjes së marrëdhënieve financiare për këta nëpunës, deri në përfundim të periudhës pandemike, referuar Vendimit 867, datë 11.11.2020, të Këshillit të Ministrave dhe situatës problematike që mund të rrjedhin nga procedurat e rindërtimit, për arsyet e mëposhtme:

- për shkak të pasojave të lëna nga tërmeti i muajit Nëntor 2019;
- për shkak të pandemisë së shkaktuar nga Covid 19, ku punonjësit e Bashkisë Tiranë kanë përballuar dhe përballojnë një fluks të shtuar të punëve të tyre funksionale;
- për Njësinë Administrative Zall-Bastar, si një nga zonat më të thella të Bashkisë Tiranë me lëvizje të brendshme demografike e rrjedhimisht me një numër përherë të ndryshëm të individëve që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shoqëror dhe familjeve në ndihmë ekonomike *****, si një nga specialistët më me eksperiencë në Zyrën e Shërbimeve Sociale ka qenë ndihmë e patjetërsueshme në grumbullimin e informacioneve dhe statistikave nëpërmjet shërbimeve publike dhe private që veprojnë në territorin e Njësive Administrative në funksion të njohjes së problemeve në zonë;
- në kushtet e pandemisë të cilat kanë sjellë mungesë të personelit për shkaqe shëndetësore ***** si një nga dy punonjësit e kësaj zyre ka qëndruar në detyrë për të kryer pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe të personave që kanë nevojë për shërbime të përkujdesit shëndetësor. Ka ndihmuar dhe orientuar personat me aftësi të kufizuar në përgatitjen e dosjeve dhe i ka përcjellë këto dosje në KMCAP;

- Ka qenë e nevojshme që ***** të vazhdojë punën në identifikimin, vlerësimin dhe koordinimin e veprimeve dhe shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe partnerët lokalë që veprojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve;
- Gjendur në situatën e lartpërmendur edhe nëpunësit e Auditit të Brendshëm janë përballur me shtim të numrit të auditimit sipas planit vjetor dhe standardeve ndërkombëtare, ligjit, manualit dhe kartës së auditit të brendshëm. Vijimi i punës së ***** si një nga Kryeinspektorët më me eksperiencë në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm ka qenë një domosdoshmëri në përfundimin e raportit vjetor, ndryshimet gjatë zbatimit të tij dhe dërgimin e konkluzioneve pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditit të brendshëm sipas të dhënave që kërkohen nga audituesit.

Në analizë të sa më lart kur, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së punës për nëpunësit: *****, në pozicionin e punës “*Specialist i Përkrahjes Sociale, Zyra e Shërbimeve Sociale, Njësia Administrative Zall-Bastar*” dhe *****, në pozicionin e punës “*Kryeinspektor, Auditi i Brendshëm*”, Bashkia Tiranë, do të sillte pengesa në realizimin e detyrave të mësipërme, si dhe do të krijonte pengesa në ecurinë normale të punës së institucionit, vlerësoj se, kërkesa për shtyrjen e afatit për ekzekutimin e Vendimit Paralajmërues nr. 183, datë 15.12.2020, “*Mbi paralajmërimin e institucionit Bashkia Tiranë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*”, të Komisionerit, nga ana e institucionit Bashkia Tiranë në lidhje me këto dy nëpunës është e drejtë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, kreu IV “*Rishikimi*”, nenet 144, 145 dhe 146, si dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të ndryshoj pikën 3, të Vendimit nr. 183, datë 15.12.2020, me përmbajtje si më poshtë:

“3. Të vijojë marrëdhënia në shërbimin civil për nëpunësit: *****, në pozicionin e punës “*Specialist i Përkrahjes Sociale, Zyra e Shërbimeve Sociale, Njësia Administrative Zall-Bastar*” dhe *****, në pozicionin e punës “*Kryeinspektor, Auditi i Brendshëm*”, Bashkia Tiranë, deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit për plotësimin e këtyre pozicioneve.”

2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Bashkia Tiranë dhe Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të institucionit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha